

Vendim nr. 99 datë 10.05.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Elsa Toska,	Kryesuese
Sonila Bejtja,	Anëtare
Genti Ibrahimimi,	Anëtar

në datën 10.05.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 3 (D) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: DASHMIRA ZARO

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-312, datë 17.01.2024 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm për çështjen civile nr. 21246-04097-30-2023, të regjistruar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në datën 19.10.2023, dhe shqyrtimin e saj brenda 6 muajve.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6, pika 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Elsa Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja është trashëgimtare ligjore e të ndjerit Th.Z., i cili, në cilësinë e trashëgimtarit të prezumuar, së bashku me shtetasin M.L., të subjektit të shpronësuar J.M., ka pretenduar tek organet administrative dhe gjykata njohjen e së drejtës së pronësisë dhe të drejtën e kompensimit për sipërfaqen 158 dynym tokë bujqësore në fshatin Jorgucat, Gjirokastrë.

2. Me vendimin nr. 23-2013-1436, datë 26.05.2013, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë ka vendosur rivendosjen në afat të së drejtës së Th.Z. për t'iu drejtuar Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (AKKP) me kërkesën për njohjen dhe kthimin e pronës së ish-pronarit J.M. Në bazë të këtij vendimi, shtetasi Th.Z. i është drejtuar AKKP-së, e cila në datën 30.09.2014 i ka kthyer përgjigje se kufijtë e pronës duhen saktësuar gjyqësisht. Në vijim, shtetasi Th.Z. i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë me kërkesën për vërtetimin e faktit juridik të kufijve të pronës, e cila, me vendimin nr. 384, datë 23.09.2014, ka pranuar kërkesën duke saktësuar kufijtë e pronës për sipërfaqen e përgjithshme të tokës bujqësore.

3. Në datën 09.07.2020 Agjencia e Trajtimit të Pronave (ATP), së cilës i kanë kaluar të drejtat dhe detyrimet e AKKP-së, ka njoftuar shtetasin Th.Z. se në lidhje me dosjen nr. 348, datë 14.09.2016, në emër të subjektit të pretenduar Th.Z., duhet t'i drejtohet gjykatës për sa kohë që afati ligjor për trajtimin e kërkesave nga ky institucion ka përfunduar më 23.02.2019.

4. Si pasojë e mosshqyrtimit të kërkesës nga ATP-ja, në datën 28.03.2019 shtetasi Th.Z. i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë me padi me objekt konstatimin e shkeljes së afatit ligjor për nxjerrjen e vendimit nga ATP-ja, si dhe njohjen e së drejtës së pronësisë për sipërfaqen 158 dynym tokë bujqësore në emër të përfituesit Th.Z.

5. Me fillimin e procesit gjyqësor në shkallë të parë, M.L., palë e tretë në atë gjykim, gjithashtu, si trashëgimtar i pretenduar i ish-pronarit J.M., i ka dhuruar shtetasit J.Z. (djalin dhe aktualisht trashëgimtar i Th.Z.) të drejtën e kompensimit për pjesën e tij takuese. Për këtë arsye, J.Z. ka paraqitur kërkesë në atë gjykatë për të ndërhyrë si person i tretë në gjykim, së bashku me padinë me objekt detyrimin e paditësit Th.Z. (të atit) ta njohë si bashkëpronar në pronën objekt gjykimi. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me vendimin e ndërmjetëm të datës 22.07.2019, ka vendosur mospranimin e kërkesës. Ndaj atij vendimi, shtetasi J.Z. ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë dhe, për këtë shkak, gjykimi i çështjes në gjykatën e shkallës së parë është pezulluar. Gjykata e Apelit Gjirokastrë, me vendimin e datës 26.11.2019,

ka vendosur pranimin e kërkesës së J.Z., prishjen e vendimit të ndërmjetëm të gjykatës së shkallës së parë dhe kthimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë.

6. Ndërkohë që zhvillohej procesi gjyqësor në shkallë të parë, më 09.12.2020, rezulton se shtetasi Th.Z. ka ndërruar jetë dhe është bërë kalimi procedural tek trashëgimtarët (bashkëshortja dhe fëmijët). Për pasojë, J.Z., djali i të ndjerit Th.Z., nga palë e tretë, u legjitimua si paditës në atë gjykim, së bashku me kërkuesen Dashmira Zaro, bashkëshortja e të ndjerit dhe shtetasen E.Z., vajza e të ndjerit.

7. Lidhur me zhvillimin e atij procesi gjyqësor, shtetasi J.Z. i është drejtuar gjykatës së apelit me kërkesë për konstatimin e tejzgjatjes së pajustificuar të procedurave gjyqësore nga ana e gjykatës së shkallës së parë, për të cilën Gjykata e Apelit Gjirokastrë, me vendimin nr. 20-2022-171/04, datë 23.03.2022, ka vendosur rrëzimin e saj. Ky shtetas i është drejtuar në vijim edhe Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesën e datës 20.06.2022, për shfuqizimin e vendimit nr. 20-2022-171/04, datë 23.03.2022 të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, si të papajtueshëm me Kushtetutën dhe konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si rezultat i tejzgjatjes së pajustificuar të procedurave të gjykimit nga gjykata e shkallës së parë. Në lidhje me këtë kërkesë, Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 134, datë 12.10.2022, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, pasi i ka gjetur pretendimet e kërkuetit haptazi të pabazuara.

8. Në përfundim të procesit gjyqësor të themelit, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë, me vendimin nr. 155 (21-2023-768), datë 16.05.2023, ka vendosur të rrëzojë kërkesëpadinë e paditësve Dashmira Zaro, J.Z. dhe E.Z., duke arsyetuar se pretendimet e palës paditëse lidhur me të drejtën si përfitues nga trashëgimia ligjore e ish-pronarit J.M., si dhe pretendimet lidhur me njohjen e së drejtës së pronësisë të vetë këtij të fundit, nuk u arritën të provoheshin gjatë gjykimit. Kundër atij vendimi është ushtruar ankimi në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë nga paditësit.

9. Mbi bazën e këtij ankimi, në gjykatën e apelit është regjistruar çështja nr. 21246-04097-30-2023, në datën 19.10.2023. Me kërkesën e datës 30.11.2023 kërkuësja ka paraqitur në Gjykatën e Lartë kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të përfundimit të gjykimit në apel dhe urdhërimin e kësaj të fundit që ta gjykojë çështjen sa më parë.

10. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-312, datë 17.01.2024, ka vendosur rrëzimin e kërkesës se kërkueses, pasi ka vlerësuar se nuk konstatohet shkelje e afatit të arsyeshëm për shqyrtimin e çështjes, duke qenë se nga momenti i regjistrimit të çështjes në gjykatën e apelit, deri në momentin e paraqitjes së kërkesës për konstatimin e cenimit dhe

përshpejtimin e procedurave në Gjykatën e Lartë, kanë kaluar vetëm 41 ditë nga afati ligjor 2-vjeçar.

11. Në datën 20.02.2024 (sipas shërbimit postar), kërkuësja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me ankim kushtetues individual sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 12.03.2024.

II

Pretendimet e kërkuësës

12. **Kërkuësja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimet e kundërshtuara i kanë cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor, në drejtim të:

12.1. *Së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm*, pasi shqyrtimi administrativ i kërkesës në AKKP dhe ATP ka zgjatur përreth 5 vjet, ndërsa në shkallë të parë përreth 4 vjet. Koha e kaluar gjatë shqyrtimit administrativ dhe atij në shkallë të parë i jep të drejtë kërkuësës për t'iu shqyrtuar çështja me përparësi në gjykatën e apelit, bazuar në vendimin nr. 78, datë 30.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit” (KLGJ) (vendimi nr. 78, datë 30.05.2019 i KLGJ-së).

12.2. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi, sipas Gjykatës së Lartë, në kushtet kur nuk konstatohet që afati i arsyeshëm të jetë shkelur, do të ishte e tepërt të analizohej mënyra e zbatimit konkret të kriterëve të arsyeshmërisë së kohëzgjatjes së procesit, në rastin objekt shqyrtimi, ndërkohë që nuk ka asnjë referencë për arsytimin se përse nuk janë të zbatueshme në rastin konkret.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuësës

13. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe

rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Këto kritere paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej këtyre kritereve që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

14. Duke verifikuar plotësimin e këtyre kritereve, në rastin konkret, Kolegji vlerëson se kërkuësja legjitimohet *ratione personae*, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

15. Një kriter tjetër paraprak është edhe ai për *shterimin e mjeteve juridike efektive*, i parashikuar nga nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000, që kërkon shfrytëzimin në rrugë normale të mjeteve juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Gjykata ka theksuar se ky lloj ankimi kushtetues është mjeti juridik në dispozicion të individit për të garantuar të drejtën për proces të rregullt dhe në këto raste, bazuar në nenin 42 të Kushtetutës, ajo shqyrton pretendimin kryesor që lidhet me kohëzgjatjen e procesit të kundërshtuar, ndërsa procedurat dhe vendimet gjyqësore të zakonshme që kanë shqyrtuar këto kërkesa, në kuptim të neneve 399/1 e vijues të Kodit të Procedurës Civile (KPC)-së, janë në funksion pikërisht të kësaj të drejte kushtetuese (*shih vendimet nr. 6, datë 15.02.2024, nr. 64, datë 30.11.2023; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, individi duhet t’iu drejtohet gjykatave të zakonshme, në përputhje me parashikimet e KPC-së dhe vetëm pasi të ketë shteruar garancitë e mbrojtjes që i ofrohen nga juridiksioni i zakonshëm gjyqësor, ai mund të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues (*shih vendimet nr. 46, datë 03.10.2023; nr. 44, datë 26.09.2023; nr. 2, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Në këtë drejtim, Kolegji konstaton se kërkuësja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pasi ka paraqitur më parë në Gjykatën e Lartë kërkesë për konstatimin e cenimit dhe përshpejtimin e procedurave, në zbatim të nenit 399/6 të KPC-së. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-312, datë 17.01.2024, ka vendosur rrëzimin e kësaj kërkesë. Për rrjedhojë, i vetmi mjet në dispozicion i kërkuësës për rivendosjen e së drejtës së pretenduar të cenuar është ankimi kushtetues individual.

17. Kërkuësja legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 17.01.2024, ndërsa kërkesa është paraqitur në

këtë Gjykatë në datën 20.02.2024 (sipas shënimit të shërbimit postar), pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

18. Për sa i takon legjitimitet *ratione materiae*, Kolegji vëren se, në thelb, kërkuesja ka pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në drejtim të kohëzgjatjes së arsyeshme të procesit gjyqësor ku ajo është palë në gjykatën e apelit. Kërkuesja ka ngritur edhe pretendimin që lidhet me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, pretendim që është i lidhur dhe në funksion të kësaj të drejte kushtetuese (pretendimit kryesor), pasi kundërshton vendimin e Gjykatës së Lartë, i cili rrëzon kërkesën e saj për përshpejtimin e procedurave nga gjykata e apelit. Për këtë arsye, Kolegji vlerëson që këtë pretendim ta shqyrtojë në këndvështrimin e së drejtës për kohëzgjatje të arsyeshme të gjykimit, për sa vijon.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm

19. Kërkuesja ka pretenduar se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, duke iu referuar procesit në tërësinë e tij. Kërkuesja ka argumentuar se shqyrtimi administrativ i çështjes së saj ka zgjatur përreth 5 vjet, ndërsa procesi gjyqësor në shkallë të parë përreth 4 vjet. Për rrjedhojë, ajo pretendon se gjykata e apelit duhet ta shqyrtojë çështjen e saj sa më parë, pasi, referuar vendimit nr. 78, datë 30.05.2019 të KLGJ-së, kohëzgjatja e procesit dhe mosha 77-vjeçare e kërkueses duhet të konsiderohen si shkaqeve veçanërisht të rënda dhe të motivuara për përshpejtimin e gjykimit të çështjes në gjykatën e apelit.

20. Neni 42 i Kushtetutës parashikon, ndër të tjera, se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave kushtetues e ligjorë ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm. Në këtë kuptim, kërkesat për të vlerësuar arsyeshmërinë e kohëzgjatjes së procesit në jurisprudencën e Gjykatës janë trajtuar në këndvështrim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Gjykata, lidhur me këto kërkesa, ka theksuar se arsyeshmëria e zgjatjes së procesit duhet të vlerësohet mbi bazën e kritereve të përcaktuara në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut që lidhen me: (i) sjelljen e kërkuesit; (ii) kompleksitetin e çështjes; (iii) sjelljen e autoriteteve; (iv) rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuesi (*shih vendimet nr. 2, datë 17.02.2022; nr. 33, datë 01.11.2021; nr. 16, datë 16.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka pohuar se KPC-ja ka përcaktuar se çfarë do të konsiderohen afate të arsyeshme (*neni 399/2*), shpërblim i drejtë (*neni 399/3*), cila është gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e procedurave (*nenet 399/4 dhe 399/6*), rregullat për gjykimin e kërkesës (*neni 399/7*) etj. Po

kështu, Gjykata ka pohuar se KPC-ja ka parashikuar jo vetëm kohëzgjatjen që konsiderohet e arsyeshme për secilën fazë dhe shkallë të procesit, por edhe të drejtën e individit palë në procedura, që të përdorë mjetet parandaluese në secilën fazë dhe shkallë gjykimi, kërkesë që, në çdo rast, shqyrtohet nga një gjykatë më e lartë se gjykata në vonesë, kurse në Gjykatën e Lartë nga një koleg tjetër i saj. Në vlerësimin e Gjykatës, edhe pse vlerësimi i kërkesave për shkelje të afatit të arsyeshëm, në kuptim të parashikimeve procedurale të neneve 399/1 e vijues të KPC-së, bëhet në përputhje me rrethanat konkrete të çdo çështjeje të veçantë, kohëzgjatjen tërësore të saj dhe pasojat e kësaj kohëzgjatjeje në të drejtat e kërkuarit, qëllimi parësor i këtyre mjeteve juridike është njohja e shkeljes së kërkesës për “afat të arsyeshëm”, sipas nenit 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së dhe parandalimi i zgjatjes në mënyrë të tepruar të afatit të procesit përmes përshpejtimit të tij dhe, në eventualitet, korrigjimi i vonesave të ndodhura përmes shpërblimit të dëmit (*shih vendimin nr. 11, datë 27.02.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Në vështrim të standardeve të sipërcituara dhe nën dritën e rrethanave të rastit konkret, Kolegji vlerëson nëse ka pasur tejzgjatje në rastin e kërkuarës dhe nëse ajo përbën shkelje të procesit të rregullt ligjor sipas nenit 42 të Kushtetutës.

23. Konkretisht, Kolegji konstaton se mbi bazën e ankimit të kërkuarës për vendimin gjyqësor të themelit të gjykatës së shkallës së parë, në gjykatën e apelit është regjistruar çështja nr. 21246-04097-30-2023, në datën 19.10.2023. Në datën 30.11.2023, pasi kishin kaluar vetëm 41 ditë nga regjistrimi i çështjes në objekt në apel, kërkuarja ka paraqitur në Gjykatën e Lartë kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të përfundimit të gjykimit në gjykatën e apelit, duke kërkuar edhe urdhërimin e kësaj të fundit që ta gjykojë çështjen sa më parë. Këtë pretendim kërkuarja e ka bazuar në vendimin nr. 78, datë 30.05.2019 të KLGJ-së, pasi kohëzgjatja e procesit dhe mosha 77-vjeçare e kërkuarës duhet të konsiderohen si shkaqe veçanërisht të rënda dhe të motivuara për përshpejtimin e gjykimit të çështjes së saj në gjykatën e apelit.

24. Gjykata e Lartë i ka kërkuar gjykatës së apelit të paraqesë mendimin me shkrim lidhur me këtë kërkesë. Gjyqtarja e shortuar ka informuar se: (i) në datën 01.02.2023, pasi ka filluar funksionimin Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm, janë rishortuar të gjitha çështjet civile të regjistruara më parë në gjykatat e apelit që kanë pushuar së funksionuari; (ii) në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm janë shortuar në datën 02.03.2023 mbi 30.000 dosje gjyqësore; (iii) gjyqtarja relatore, deri në momentin e dhënies së mendimit me shkrim, ka pasur mbi 2500 çështje në gjykim të regjistruara që nga viti 2016; (iv) gjykata e apelit ka në organikë 24 gjyqtarë, nga 78 që duhet të ishin me organikë të plotë; (v) duke vlerësuar në tërësi shkaqet për të cilat kërkohet gjykim me përshpejtim i çështjes, në raport me

kohën e regjistrimit të çështjes në apel, me ngarkesën në punë dhe mundësitë objektive për të gjykuar të gjitha çështjet për të cilat kërkohet gjykimi me përshpejtim, gjyqtarja relatores ka arritur në përfundimin se nuk mund të pranohet kërkesa përshpejtim në këto kushte.

25. Në vendimin e saj Gjykata e Lartë, pasi ka evidentuar kriteret e elaboruara nga jurisprudenca kushtetuese për të vlerësuar nëse ka pasur tejzgjatje në shqyrtimin e kërkesës të paraqitur nga kërkuesja, dhe pas analizës së rrethanave konkrete, ka arritur në përfundimin se nuk ishte shkelur afati ligjor 2-vjeçar i parashikuar nga KPC-ja, si afat maksimal për përfundimin e gjykimit në gjykatën e apelit dhe ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Për rrjedhojë, ajo gjykatë ka çmuar se do të ishte e tepërt të bënte analizën për mënyrën e zbatimit të këtyre kriterëve në rastin konkret (*shih paragrafin 14 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

26. Kolegji thekson se, sipas fakteve të çështjes, kërkuesja ka ngritur pretendime për procesin e zhvilluar në gjykatën e apelit, i cili është regjistruar në datën 19.10.2023 në atë gjykatë, ndërsa kërkesa për përshpejtimin e procedurave është dorëzuar në Gjykatën e Lartë në datën 30.11.2023. Nga data e regjistrimit të çështjes së themelit në gjykatën e apelit, deri në datën e paraqitjes së kërkesës për përshpejtimin e procedurave në Gjykatën e Lartë, ka kaluar një periudhë kohore prej vetëm 41 ditësh, afat që është i largët nga afati maksimal 2-vjeçar i parashikuar si afat orientues për shqyrtimin e çështjeve civile në gjykatën e apelit, ndërkohë që nga data e regjistrimit të çështjes së themelit në gjykatën e apelit, deri në datën e paraqitjes së këtij ankimi kushtetues individual në Gjykatë, kanë kaluar rreth 4 muaj.

27. Në analizë të sa më sipër, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual i kërkueses nuk duket se duhet t'iu nënshtrohet standardeve jurisprudenciale të Gjykatës për analizën e secilit prej katër kriterëve më vete, për të vlerësuar nëse ka ose jo cenim të afatit të arsyeshëm (*shih paragrafin 20 të këtij vendimi*), pasi ajo e ka paraqitur ankimin vetëm 41 ditë nga regjistrimi i çështjes së themelit në gjykatën e apelit. Në këtë kontekst, Kolegji vëren se edhe vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë nuk rezulton të jetë kontradiktor, alogjik, i pamjaftueshëm, me kundërthënie ose në mungesë të elementeve formale të parashikuara nga dispozitat ligjore dhe standardet e vendosura nga jurisprudenca e Gjykatës (*shih paragrafët 24 dhe 25 të këtij vendimi*). Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se nuk është përpara situatës së tejzgjatjes së afatit të arsyeshëm të gjykimit në rastin e kërkueses, ndaj dhe kërkesa nuk përmbush kriterin e legjitimitetit *ratione materiae*.

28. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “a” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.